

# SISTEMIMI NË SHKOLLË PREJ FAZËS THEMELVËNËSE TE FAZA KYÇE 1 PRINDËRIT U NDIHMOJNË FËMIJËVE TË RUHEN, TË JENË TË LUMTUR DHE TË MËSOJNË



## HYRJE: KËNAQËSIA DHE ARRITJET

Mësimi mund të jetë kënaqësi për fëmijët e moshës së re – ata kërkojnë, hetojnë, zbulojnë, krijojnë, zbatojnë, ushtrijnë, përsërisin, rishikojnë dhe forcojnë dijen zhvilluese, zotësitë, kuptimin dhe qëndrimet e veta. Gjatë fazës themelvënëse shumë prej këtyre aspekteve të mësimit koordinohen nëpërmjet lojës dhe bisedës.

Shkollat janë duke punuar sipas linjës së re të veprimit të quajtur "Çdo fëmijë ka rëndësi" [Every Child Matters]. Këto janë parimet themelore që synon t'i zbatojë në veprë kjo mënyrë veprimi:

- shëndeti
- siguria
- kënaqësia dhe arritjet
- kontributi pozitiv
- mirëqenia ekonomike

## ZHVILLIMI PERSONAL, SOCIAL DHE EMOCIONAL

- fëmijët mësohen që ta respektojnë vetveten dhe të tjerët
- fëmijët mësojnë për lidhjet dhe për miqësinë
- fëmijët zhvillojnë dashuri për mësimin
- fëmijët fitojnë vetëbesim dhe pavarësi

## KOMUNIKIMI, GJUHA DHE SHKRIMLEXIMI

- mësojnë të kënaqen duke folur e dëgjuar dhe duke e ndërruar radhën gjatë bisedës
- mësojnë të kënaqen së bashku me të tjerët me lloj-lloj tregimesh, rimash, muzike, këngësh dhe poezish
- zhvillojnë gjuhën dhe mësojnë me kohë shkrim e lexim

Matematika dhe zgjidhja e problemeve:

- të dallohen mostrat
- të krijohen ndërlidhjet
- të punohet me numra, me forma, me hapësirë dhe me masa
- numërimi, radhitja dhe bashkërendimi

Njohuritë mbi botën dhe të kuptuarit e saj:

- kërkimi, vëzhgimi, zgjidhja e problemeve, diskutimi
- si të përdoren kompjuterët, fotoaparartet, etj.
- pyetjet e hapura të llojit "Si mundemi të...?" ose "Çfarë do të ndodhte sikur...?"

Zhvillimi trupor:

- të stërvitet vetëdija për hapësirën, për vetveten dhe për të tjerët
- lëvizja me vetëbesim, me imagjinatë dhe në siguri – brenda dhe jashtë hapësirave të mbyllura
- lëvizja e kontrolluar dhe e koordinuar
- ecja në pajisje për ngjitje dhe për balancim, ecja përreth tyre, ndër to, mbi to, nëpër to.

## ZHVILLIMI KRIJUES

Të shprehen dhe të komunikohen idetë, mendimet dhe ndjenjat duke përdorur lloj-lloj materialesh, mjetesh, inskenimesh me role të ndryshme, lëvizjesh, dizajnimesh dhe punimesh, këngësh dhe instrumentesh muzikore.

## SI MUND TA NDIHMONI MËSIMIN E FËMIJËS SUAJ?

- Çdo përvojë e re na lodh – mundohuni të përkujdeseni që fëmija juaj të flejë sa duhet.
- Jepuni të hanë diçka të shëndetshme për mëngjes që të mbeten të zgjuar gjatë ditës.
- Shtroni pyetje të hapura – "Si e ndiejnë veten...?" ose "Çfarë do të ndodhte sikur...?"
- Dëgjojini me durim.
- Pushoni dhe lexoni së bashku ndonjë tregim kurdo që të keni kohë.
- Më vonë gjatë shkollimit fëmijët tuaj mund të sjellin libra me vete – mundohuni që të gjeni pak kohë gjatë ditëve tuaja të mundimshme që ta lexoni librin së bashku po atë mbrëmje.
- Ofroni që të vini në shkollë dhe ta ndani përvojën tuaj me klasën – për shembull duke folur me ta për familjen tuaj, për ndonjë festë që festoni ose për punën tuaj.
- Merrni pjesë në udhëtimet e klasës dhe në shëtitje nëse mundeni.
- Flisni me mësuesin e fëmijës suaj lidhur me projektet që janë duke i kryer dhe sillni me vete ndonjë gjë nga shtëpia juaj që mund të shërbejë si ndihmë.
- Vazhdoni ta lavdëroni, ta doni dhe ta qetësoni fëmijën tuaj gjatë kësaj periudhe ndërrimesh të mëdha nga njëra fazë në tjetrën, dhe ata do të vazhdojnë të kënaqen duke mësuar.
- Nëse dini diçka që do t'ia lehtësonte qasjen fëmijës suaj në shkollë, thujani mësuesit.
- Tregoni nëse ju shqetëson ndonjë gjë në veçanti, për shembull nëse dini që ka gjëra që do të mund t'i bënte shkolla për t'ia lehtësuar fëmijës suaj mësimin.

**Për informata dhe këshilla të mëtejme** mund ta vizitoni website-in e Qeverisë "Learning Journey" [www.parentscentre.gov.uk/learnjourn/index\\_ks1.cfm?ver=graph](http://www.parentscentre.gov.uk/learnjourn/index_ks1.cfm?ver=graph)

*Ju lutemi shënojinë në vazhdim njoftimet lokale dhe mundësitë e kontaktimit*

Të gjitha të drejtat e rezervuara © Crown, gusht 2006.